

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 09.02.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.02.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik ___Al Group PRO SH.P.K, Swiss Village, nr 7 Çagllavicë Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Hartimi i projekteve detale 3 llote**", me Nr. të Prok: 613-22-10640-2-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Al Group PRO SH.P.K, Swiss Village, nr 7 Çagllavicë Prishtinë datës 07.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projekteve detale 3 llote", me Nr. të Prok: 613-22-10640-2-1-1 kundër *Vendimit të AK –së*, të datës 03.02.2023 të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për:

Llot 1 Grupin e operatorve ekonomik Eng group shpk& Master architects shpk Prishtine,

Llot 2 Studio Hapsira shpk & Taulant shpk Prishtine,

Llot 3 Grupi i operatorëve ekonomik Infra- Plus shpk& Alb architect shpk Prishtine, të publikuar me datë: 03.02.2023.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **Arhiko ing O.P, nga Prishtina** më datë 07.02.2023 ka parashtuar ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projekteve detale 3 lloje", me Nr. të Prok: 613-22-10640-2-1-1 **për shpërbllim me kontratë, për:**

Llot 1 Grupin e operatorve ekonomik Eng group shpk& Master architects shpk Prishtine,

Llot 2 Grupi i operatorve ekonomik Studio Hapsira shpk & Taulant shpk Prishtine,

Llot 3 Grupi i operatorve ekonomik Infra- Plus shpk& Alb architect shpk Prishtine, të datës 03.02.2023 te publikuar ne platformen elektronike e-prokurimi.

Autoriteti Kontraktues, me datë 08.02.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë.

Pretendimi i parë.

Sqarimi për konkludimin e OE ankues se nuk është bërë rivlersimi dhe nuk është kërkuar sqarim por vetëm është përseritur Vendimi.

Ky konstatim nuk qëndron për arsye se komisioni për rivlersim ku e ka pa të arsyeshme për të kërkuar sqarim ka kërkuar siq është rasti që me letër standarde për sqarim i është kërkuar "O.E.Eng Idea" Suharekë .

Pretendimi se operatorët ekonomik të cilët me vendim të Autoritetit kontraktues janë rekomanduar për kontratë nuk e kanë sigurimin e ekzekutimit sipas kërkeses në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit nuk qëndron sepse sigurimi është në vlerën e kërkuar për secilin llot.

Pretendimi 1 per dokumentet e ATK-se dhe Gjykates te Operatoreve Ekonomik te rekomanduar per kontrate nuk qendron per arsye se këto dokumente janë në baze të kërkesave të Autoritetit Kontraktues që mos të jenë më të vjetra se 3 muaj para publikimit për kontratë e jo siq pretendon O.E ankues që vërtetimi të jetë më i vjetër se 3 muaj para publikimit të njoftimit për kontratë. Kjo e verteton se O.E që kanë sjellë Vërtetimin nga ATK në momentin e dorëzimit dmth. në janar të vitit 2023.

Pretendimi 2 është i njejtë me të parin që dmth se vërtetimi është i muajit tetor që dmth nuk është në vonësë në pagimin e tatimeve .

Pretendimi 3 se Grup i Operatorëve Ekonomik Infra-Plus SH.P.K.; ALB - Architect SH.P.Kështë i pa përgjegjshëm nuk qëndron se G.O.E në fjalë në llot 1 dhe llot 3 nuk kanë gabime në paramasë por vetëm në llotin 2 dhe për këtë llot ky grup i operatorëve ekonomik është i eliminuar dhe kjo mund të shihet nga letra standarde për tenderuesit e eliminuar

Pretendimi 4 se një OE i përgjegjshëm është në 2 a më shumë lloje, duhet të shpërblehet me llotin që ka çmimin më të lartë.


Ka tendencë të keq interpretohet ky nen sepse kjo është kur një O.E. ka ofertuar në më shumë lloje dhe është më i lirë në më shumë se një llot e që në këtë rast nuk kemi, sepse në të gjitha llojet është shpallur fitues tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më të lirë

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit